

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6804
E martë, 17 janar 2023
çmimi 0.40

Tërheqja e mjeteve nga
Trusti shqyrtohet sërish
të enjten në Kuvend



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA DHE MINISTRJA E JASHTME E SLOVENISË, TANJA FAJON,
PO QËNDRON PËR VIZITË NË KOSOVË

FAJONI KËRKON TË NISIN NEGOCIATAT PËR PROPOZIMIN FRANKO-GJERMAN



Zëvendëskryeministrja dhe ministrja e jashtme e Sllovenisë, Tanja Fajon, ka thënë se Kosova dhe Serbia duhet t'i fillojnë negociatat për planin franko-gjerman. Në një konferencë të

përbashkët për medie me ministrën e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla, Fajon ka theksuar se Sllovenia mbështet dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, duke potencuar se të

gjithë janë të shqetësuar për rreziqet e sigurisë në Ballkan. "Të gjithë jemi të shqetësuar për rreziqet e sigurisë në Ballkan. Kemi nevojë për një Ballkan dhe Kosovë të fortë", ka thënë Fajon

OPINION

KURTI PËRKUJTON
POLITIKANIN SERB I PËRLYER
NË VRASJEN E SHOQPTARËVE,
MAVRAJ: JO NË EMRIN
TIM! F. 8

AKTUALE



SHOQPËRIA NIS NOTË VERBALE
NDAJ BRITANISË PËR GJUHËN E
PËRDORUR NDAJ MIGRANTËVE F. 7

NGRIHET AKTAKUZË PËR
MASHTRIMIN E MBI 40 KLIENTËVE
NË VLERË MBI 44 MIJË EURO F. 7

EKONOMI



KOSOVË, SFIDAT E ZHVILLIMIT
EKONOMIK NË VITIN 2023 F. 8

MURATI: REFORMA E SKEMAVE
SOCIALE DHE PENSIONALE ËSHTË E
DOMOSDOSHME F. 8

SPORT



TRE VËLLEZËRIT BOKSIERË NGA
GJAKOVA SYNOJNË T'I SJELLIN
KOSOVËS MEDALJE NDËRKOMBËTARE

PSD-ja ZËVENDËSON
FLAMUJT PARA
MPJD-SË ME
KARTËMONEDHËN
500-EUROSHE
ME FYTYRËN E
AMBASADORIT
BERISHAJ



SHOQPËRIA NDERON ME MEDALJEN
"KALORËSI I URDHRI TË
FLAMURIT" WILLIAM WALKERIN

RENOVA
PUTZ
Mqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mbx: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Shqipëria nis notë verbale ndaj Britanisë për gjuhën e përdorur ndaj migrantëve

TIRANË, 16 JANAR - Shqipëria i ka dorëzuar të hënën notë verbale Britanisë së Madhe, për retorikën e përdorur nga zyrtarë të lartë britanikë, të cilën Tirana zyrtare e ka cilësuar “gjuhë urrejtëse dhe diskriminim” ndaj emigrantëve shqiptarë.

Ministrja për Evropën dhe Punët e Jashtme në Shqipëri, Olta Xhaçka, ka njoftuar se nota verbale i është dorëzuar ambasadorit britanik në Tiranë, Alastar King Smith.

Ky reagim vjen pas deklaratës së ministrit britanik të Emigracionit, Robert Jenrick, i cili pak ditë më parë ka publikuar një video në “Twitter”, në të cilën ka theksuar se ka ndjekur personalisht momentet e debimit të disa shqiptarëve drejt Tiranës dhe i ka

konsideruar disa prej tyre kriminelë të rrezikshëm.

Xhaçka i është kundërpërgjigjur se është shokuar me këto deklarata, derisa gjuhën e përdorur nga ministri britanik e ka konsideruar si “linçim ndaj gjithë kombit”.

Ajo ka thënë se në notën verbale që i është dorëzuar ambasadorit britanik, theksohet se “kjo retorikë e përsëritur cenon frymën pozitive të bashkëpunimit dypalësh, të konfirmuar në deklaratën e përbashkët mes kryeministrave Edi Rama dhe Rishi Sunak”.

Përmes këtij reagimi zyrtar kërkohet shmangia e gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimi, si dhe vazhdimi i dialogut dhe bashkëpunimit mes dy vendeve për këtë dhe çështje të tjera.

Pak kohë më parë edhe

ministrja e Brendshme britanike, Suella Braverman, i pati cilësuar shqiptarët si “kriminelë”.

Ndaj kësaj deklarate pati reaguar kryeministri shqiptar, Edi Rama, si dhe qindra shqiptarë patën protestuar në Londër.

Emigrantët e paligjshëm janë kthyer në problem serioz për Britaninë, dhe sipas zyrtarëve në Londër, katër në 10 emigrantë të paligjshëm janë shqiptarë.

Dy vendet kanë arritur një marrëveshje për këtë gjë në dhjetor të vitit të kaluar.

Palët janë pajtuar për krijimin e një task-force për të frenuar këtë fenomen dhe për të zbatuar disa masa konkrete për ri-integrimin e emigrantëve që do të kthehen në Shqipëri.



Jep dorëheqje ministrja gjermane e Mbrojtjes



Berlin, 16 janar - Ministrja gjermane e Mbrojtjes, Christine Lambrecht, ka dhënë dorëheqje nga qeveria e kryeministrit Olaf Scholz. Në deklaratën me shkrim ajo ka përmendur “muajt të fokusit medial” mbi të dhe se diçka e tillë ka ndërhyrë në debatin faktik për ushtrinë dhe politikën e Gjermanisë për sigurinë.

“Puna e vlefshme e ushtarëve dhe e shumë njerëzve në departamentin tim duhet të jetë në plan të parë”, ka thënë ajo. Vendimi i saj është goditje për Scholz, në kohën kur Gjermania është nën presion për të miratuar ndihmën shtesë për Kievin, si dhe në kohën kur kapacitetet e Gjermanisë në

mbrojtje janë vënë në dyshim, pas heqjes nga përdorimi të tankeve Puma, gjatë stërvitjeve të fundit ushtarake.

Presioni për të gjetur një pasardhës është në rritje e sipër edhe për faktin se Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Lloyd Austin, pritet të vizitojë Berlinin të enjten dhe të marrë pjesë në një konferencë më pas të premtën në bazën ushtarake amerikane në Ramstein, për të diskutuar mbështetjen e mëtejme për Ukrainën.

Një zëdhënës qeveritar ka thënë se Lambrecht i ka kërkuar zyrtarisht kancelarit dorëheqjen dhe ai e ka miratuar atë.

E përditshmja gjermane The

Frankfurter Allgemeine Zeitung, ka cituar disa burime të saj të kenë thënë se pasardhësi i Lambrecht do të bëhet i ditur të enjten.

Lambrecht, 57-vjeçare, ka qenë ministre e Mbrojtjes prej kur Scholz është bërë kancelar, në dhjetor të vitit 2021.

Pavarësisht kritikave ndaj saj, Scholz e ka përshtetur atë si “ministre të mbrojtjes të klasit të parë”.

Lambrecht ka qenë e përfshirë në qeveritë e kaluara në sektorin e financave, si dhe në atë të grave dhe familjeve. Ajo ka qenë e respektuar në ato role, mirëpo ka pasur kritika se nuk ka pasur lidhjet e duhura me Ministrinë e Mbrojtjes.

Frontex: 45 për qind e migrantëve të parregullt kaluan nga Ballkani drejt Evropës në 2022-n

PRISHTINË, 16 JANAR - Rruga e Ballkanit Perëndimor përbënte gati 45 për qind të totalit të migrantëve të parregullt që u ndaluan në kufijtë e jashtëm të Bashkimit Evropian gjatë viti 2022, ka bërë me dije, përmes raportit më të fundit vjetor, Agjencia Evropiane e Ruajtjes së Kufijve, “Frontex”.

Rreth 145 600 kalime të parregullta kufitare u raportuan në itinerarin e Ballkanit Perëndimor, ku bën pjesë edhe Shqipëria, të cilat përbënin rreth 136 për qind më shumë se në vitin 2021.

Raporti i “Frontex”-it pohon se ky është numri më i lartë i kalimeve të parregullta të raportuara në këtë rrugë që nga viti 2015.

Sipas raportit të “Frontex”-it shtetasit e Sirisë, Afganistanit dhe Turqisë përbënin numrin më të

madh të migrantëve të parregullt, por u raportuan kombësi që më parë kishin qenë pak në këtë rrugë, si tunizianët, indianët dhe burundistët.

Në vitin 2022, sipas përlogaritjeve paraprake të “Frontex”-it, rreth 330 000 kalime të parregullta kufitare u zbuluan në kufirin e jashtëm të Bashkimit Evropian nga të gjitha rrugëkalimet duke shënuar numrin më të lartë të migrantëve që nga viti 2016 dhe një rritje prej 64-përqindësh nga viti i kaluar.

Sipas raportit sirianët, afganët dhe tunizianët së bashku përbënin 47 për qind të migrantëve të parregullt në vitin 2022. “Pas nivelit të ulët të shkaktuar nga pandemia në vitin 2020, ky ishte viti i dytë me radhë me një rritje të madhe të numrit të hyrjeve të



parregullta, vlerëson raporti i “Frontex”-it.

Gratë përbënin më pak se një në

dhjetën e migrantëve, ndërsa përqindja e të miturve të raportuar ra krahasuar me vitin e shkruar në

rreth 9 për qind.

Sipas “Frontex”-it, rreth 13 milionë refugjatë ukrainas u llogaritën për hyrjen në kufijtë tokësorë të jashtëm të BE-së nga Ukraina dhe Moldavia midis 24 shkurtit 2022 deri në fund të vitit, të cilët nuk përfshihen në këto shifra. Në të njëjtën periudhë, 10 milionë shtetas ukrainas u raportuan në dalje në të njëjtat seksione kufitare. Ndërkohë në Kanalin Anglez, sipas “Frontex”-it, u evidentuan gjatë vitit 2022 mbi 71 000 kalime të parregullta kufitare në dalje, duke përfshirë përpjekjet dhe kalimet e suksesshme.

Raporti pohon se mbi 50 kombësi të ndryshme të migrantëve të parregullt u regjistruan në Kanal, shumica prej tyre nga Lindja e Mesme, Shqipëria dhe Briri i Afrikës.



ZËVENDËSKRYEMINISTRJA DHE MINISTRJA E JASHTME E SLOVENISË, TANJA FAJON,
PO QËNDRON PËR VIZITË NË KOSOVË

Fajoni kërkon të nisin negociatat për propozimin franko-gjerman

Zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Jashtme e Sllovenisë, Tanja Fajon, ka thënë se Kosova dhe Serbia duhet t'i fillojnë negociatat për planin franko-gjerman. Në një konferencë të përbashkët për medie me ministren e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla, ka theksuar se Sllovenia mbështet dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, duke potencuar se të gjithë janë të shqetësuar për rreziqet e sigurisë në Ballkan. "Të gjithë jemi të shqetësuar për rreziqet e sigurisë në Ballkan. Kemi nevojë për një Ballkan dhe Kosovë të fortë", ka thënë Fajon

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 16 JANAR - Zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Jashtme e Sllovenisë, Tanja Fajon, po qëndron për vizitë në Kosovë. Ajo të hënën është takuar me ministren e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla, me të cilën, pas takimit, ka mbajtur një konferencë të përbashkët për medie. Fajon ka thënë se Kosova dhe Serbia duhet të diskutojnë për propozimin e BE-së për normalizim të raporteve. Ajo ka theksuar se nuk bën të ketë eskalim të situatës në veri të Kosovës. "Gjithmonë kam thënë që Kosova duhet të përpikët për normalizim e marrëdhënieve, nuk bën të bëhet eksklami i

situatës andej. Duhet të fillojnë negociatat për propozimin e BE-së që është në tavolinë për normalizimin e marrëdhënieve", ka thënë Fajon. Ajo ka shtuar se Sllovenia mbështet dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Ne duam që jeta të bëhet sa më e thjeshtë për të gjithë qytetarët. Të gjithë jemi të shqetësuar për rreziqet e sigurisë në Ballkan. Kemi nevojë për një Ballkan dhe Kosovë të fortë", ka thënë Fajon. Kryediplomatja sllovene ka shtuar se me ministren Gërvalla kanë folur edhe për bashkëpunimin e dyanshëm mes dy shteteve. Ajo shtoi se Sllovenia mbetet mike e Kosovës dhe se e mbështet rrugën euroatlantike të saj. Fajon përmendi liberalizimin e vizave, duke thënë se vendimet

e fundvitit ishin "sukses i përbashkët". Ndërkaq ministrja Gërvalla ka thënë se gjendja në rajon mbetet e komplikuar për shkak të luftës në Ukrainë, por edhe për shkak të problemeve të pazgjidhura mes vendeve të rajonit. Gërvalla ka falënderuar ministren e Jashtme sllovene Tanja Fajon për përpjekjet e saj të shumta për realizimin e interesave strategjike të Kosovës. Ajo ka thënë se Sllovenia ka qenë përkrahëse për realizimin e interesave legjitime të Kosovës. Gërvalla ka thënë se kërcënimet që Serbia i bën rajonit me luftë, kërkojnë një përgjigje të përbashkët. "Pa paqen dhe stabilitetin e nevojshëm në rajonin tonë dhe pa një Evropë që nuk e përfshin gjithë Evropën, sfidat do të mbesin të njëjta. Rajoni ynë ndodhet në një fazë të rrezikshme të historisë evropiane. Sllovenia është anëtare e NATO-s dhe Kosova nuk e ka fshehur asnjëherë aspiratën për t'u anëtarësuar në NATO. Kërcënimet me luftë që i bën Serbia rajonit tonë kërkojnë një përgjigje të unifikuar", ka deklaruar Gërvalla. Fajon është takuar edhe me presidenten Vjosa Osmani,

kryetarin e Kuvendit, Glauk Konjufca, kryeministrin Albin Kurti, ku temë diskutimi ishin marrëdhëniet me Slloveninë, dialogu Kosovë - Serbi dhe proceset integruese të Kosovës. Presidentja Osmani ka çmuar mbështetjen historike të Sllovenisë për Kosovën dhe për integrimin e saj ndërkombëtar. Në këtë drejtim, presidentja Osmani ka falënderuar Slloveninë për angazhimin e saj në Ballkanin Perëndimor, të cilën gjë e ka treguar edhe me emërimin e një emisari special. Po në takim u diskutua edhe përkushtimi i përbashkët i thellimit të mëtejme të bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve në fusha të ndryshme. Presidentja Osmani dhe zëvendëskryeministrja Fajon diskutuan edhe për zhvillimet aktuale në veri të vendit dhe përpjekjet e institucioneve të Kosovës për vendosjen e rendit dhe ligjit. Kurse sa i përket dialogut me Serbinë, presidentja Osmani ka potencuar se Kosova mbetet palë konstruktive, por Serbia me obstrukcionet e saj dhe duke përdorur bandat kriminale në veri të vendit po përpikët ta destabilizojë Kosovën dhe ta pengojë dialogun. Megjithatë, presidentja Osmani theksoi se

Kosova është e përkushtuar për paqe e stabilitet dhe se synim parësor mbetet integrimi euroatlantik i Kosovës. Në këtë drejtim, presidentja Osmani ka kërkuar mbështetjen e Sllovenisë për rrugëtimin euroatlantik të Kosovës dhe anëtarësimin në organizata të tjera ndërkombëtare. Edhe kryeministri Albin Kurti ka pritur në takim zëvendëskryeministren e Sllovenisë, njëherësh ministre për Punë të Jashtme të Sllovenisë, Tanja Fajon. Në këtë takim u theksua miqësia, partneriteti dhe aleanca ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Sllovenisë, si dhe të njëjtat vlera dhe pikëpamje për paqen dhe sigurinë në rajon dhe më gjerë. Kryeministri Kurti shprehu mirënjohje për kontributin e Sllovenisë para dhe pas luftës në Kosovë si dhe për përkrahjen e vazhdueshme për Republikën e Kosovës. Po ashtu, Kurti dhe Fajon kanë biseduar edhe për perspektivën evropiane të rajonit, rëndësinë e Procesit të Berlinit rreth hapave të ardhshëm drejt normalizimit të plotë të marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë me njohjen reciproke në qendër dhe për çështje të tjera aktuale.

Kurti përkujton politikanin serb i përlyer në vrasjen e shqiptarëve, Mavraj: Jo në emrin tim!

PRISHTINË, 16 JANAR - Publicisti Muhamet Mavraj ka komentuar videon e kryeministrit Albin Kurti i cili ka përkujtuar të hënën politikanin serb Oliver Ivanoviq që u vra pesë vjet më parë.

Mavraj përmes një postimi në "Facebook" ka theksuar se Oliver Ivanoviqi gjatë luftës e pas luftës është i përlyer me

vrasje civilësh. "Shqiptare, meqë ra fjala", ka shkruar Mavraj.

Publicisti Mavraj ka theksuar se pavarësisht zorit që qëndron prapa këtij përkujtimi emocional për të, dhe storieve të papara e të padëguara për Stanin, ende është kundër rrëzimit të qeverisë Kurti, dorëheqjeve apo shkarkimeve.

Postimi i plotë i Mavrajt:

Jo në emrin tim!


Dikur flitej ndryshe, me të drejtë, për terrorin në Mitrovicë. Tani asgjë nuk është për habitje.

Oliver Ivanoviqi gjatë luftës e pas luftës është i përlyer me

vrasje civilësh. Shqiptare, meqë ra fjala.

Hajt zekë hajt!

Pavarësisht zorit që qëndron prapa këtij përkujtimi emocional për të, dhe storieve të papara e të padëguara për Stanin, ende jam kundër rrëzimit, dorëheqjeve apo shkarkimeve. Pa u ngi mirë Jo! Pastaj dihet!



Gërvalla: Kosova nuk do të kërkojë rrugica për të zbatuar një asociacion që shkel Kushtetutën

PRISHTINË, 16 JANAR - Ministria për Punë të Jashtme dhe Diasporë e Kosovës, Donika Gërvalla, ka thënë të hënën se Kosova nuk do të kërkojë rrugica për të zbatuar një asociacion "i cili shkel Kushtetutën e vendit". "Cila do të jetë rrjedha e bisedave në Bruksel në kuadër të marrëveshjes finale, cilat do të jenë konsesionet që edhe Serbia do të jetë e gatshme të bëjë në raport me të drejtat e minoriteteve në Serbi e shumë e shumë tema të tjera, mbetet të diskutohen në kuadër të dialogut", ka thënë Gërvalla në një konferencë të përbashkët me ministren e Jashtme të Sllovenisë, Tanja Fajon, kur është pyetur për zbatimin e marrëveshjes për Asociacionin e Komunave me Shumicë



Serbe. "Por, Asociacioni për të cilin palët janë marrë vesh në Bruksel, por për të cilin palët janë marrë vesh që të zbatohet vetëm pasi të ketë kaluar Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, nuk mund të zbatohet sepse e shkel Kushtetutën dhe një qeveri, një gjë që nuk do të

duhej të bënte kurrë, është që të merrte vendime të cilat shkelin ligjet dhe Kushtetutën e vendit", ka shtuar Gërvalla.

Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje për Asociacionin më 2013 dhe më pas më 2015 mbi parimet për themelimin e tij.

Po më 2015 Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka gjetur se marrëveshja nuk është në harmoni të plotë me Kushtetutën.

Serbia kërkon që Kosova t'i zbatojë marrëveshjet e arritura, por Qeveria e Kosovës është deklaruar kundër një asociacioni njëetnik.

Javën e kaluar këshilltari i lartë i Departamentit amerikan të Shtetit, Derek Chollet, ka thënë se "Kosova duhet t'i përmbushë të gjitha zotimet në kuadër të dialogut, përfshirë edhe formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe" dhe se pret nga "Qeveria e Kosovës të vendosë disa propozime në tryezë".

ShBA-ja, madje, ka paralajmëruar se do të kërkojë "partnerë alternativë" për

formimin e Asociacionit në rast se Qeveria e Kosovës nuk e gjen një mënyrë për ta themeluar atë.

Gërvalla ka thënë se Kosova është e përgatitur për finalizim të procesit të dialogut dhe se dialogu duhet të nisë këtë vit me intensitet dhe jo me takime në gjashtë muaj.

Kosova dhe Serbia kanë nisur negociatat për normalizimin e marrëdhënieve më 2011 me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian.

Procesi i negociatave pritet të përfundojë me marrëveshje ligjrisht të detyrueshme.

Ndonëse Kosova deklaroi se kjo marrëveshje duhet ta përfshijë njohjen e ndërsjellë, Serbia nuk pranon, duke insistuar në "zgjidhje kompromisi".

Zgjedhjet presidenciale në Mal të Zi mbahen në mars

Podgoricë, 16 janar - Kryetarja e Parlamentit të Malit të Zi, Danijela Gjuvoviq, ka shpallur zgjedhjet presidenciale malazeze më 19 mars. "Kryetari i Kuvendit është i autorizuar dhe i obliguar t'i shpallë zgjedhjet për president të Malit të Zi jo më vonë se 120 ditë para

përfundimit të mandatit të presidentit të Malit të Zi", tha Gjuvoviq.

Mandati aktual i presidentit të Malit të Zi, Milo Gjukanoviq, nisi më 20 maj 2018.

Në mënyrë që një kandidat të fitojë në raundin e parë të zgjedhjeve presidenciale, ai

duhet të marrë mbi 50 për qind të votave.

Raundi i dytë i zgjedhjeve mbahet pas dy javësh nëse asnjëri prej kandidatëve nuk i fiton më tepër se gjysmën e votave.

Herën e fundit zgjedhjet presidenciale në Mal të Zi u mbajtën më 15 prill 2018.



Tërheqja e mjeteve nga Trusti shqyrtohet sërish të enjten në Kuvend

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 16 JANAR - Projektligji për tërheqjen e një pjese të kursimeve pensionale nga Trusti do të jetë në shqyrtim në seancën e së enjtes të Kuvendit të Kosovës. Kjo çështje do të jetë si pikë e parë e rendit të ditës. Vendimi është marrë në mbledhjen e kryesisë së Kuvendit të hënën ku janë caktuar dy seanca plenare për këtë javë. Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Ableard Tahiri, u shpreh se qytetarët janë duke prituri lejimin për të tërhequr nga 10 deri në 30 për qind të kursimeve në Fondin e Kursimeve Pensionale. "Të enjten, më 19 janar, do ta nisim sesionin pranveror të punës së Kuvendit të Republikës. Në seancën e parë të këtij sesioni, përveç që po i rikthehem kërkesës së qytetarëve për TRUST-in, po i rikthehem edhe angazhimit politik për t'i ballafaquar pikëpamjet për gjendjen shoqërore, agjendën e shtetit dhe të drejtat e qytetarëve", ka thënë Tahiri.

Ai ka thënë se sjellja e deritanishme e mazhorancës ka qenë jashtëzakonisht degraduese për nga fokusi dhe mospuna. "Si dhe jashtëzakonisht dekurajuese për të shpresuar për një këndellje të shpejtë, një nevojë kjo emergjente për krejt sferën publike. Por si grup parlamentar i PDK-së ne do të jemi bashkë me qytetarët dhe realitetin e tyre, bashkëpunues ku është interes kombëtar, këmbëngulës për ta demaskuar degradimin e pushtetit dhe aktivë e të zëshëm ndaj prioriteteve që sot i ka shoqëria jonë", është shprehur Tahiri. Mirëpo Lëvizja Vetëvendosje, si grupi më i madh parlamentar, vazhdon ta kundërshtojë këtë iniciativë.

Shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, konfirmoi se partia e saj nuk ka ndryshuar qëndrim rreth kësaj çështjeje dhe sërish e kundërshton tërheqjen e kursimeve pensionale. "Qëndrimi i grupit parlamentar i Lëvizjes



Vetëvendosje është i qartë, nuk e kemi mbështetur tërheqjen e 30-përqindëshit të Fondit të Kursimeve Pensionale. Konsiderojmë se në aspektin ekonomik mund të ketë një ndjesi të zgjidhjes në aspektin afatshkurtër, megjithatë në të

njëjtën periudhë kohore do të ketë ndikim afatmesëm dhe afatgjatë negativ edhe në mirëqenien e qytetarëve edhe në parametra të tjerë ekonomikë, përfshirë edhe ngritjen e çmimeve, sasinë e cash-it në qarkullim dhe humbjen e sigurisë për të ardhmen për të

gjithë ata që i tërheqin Fondet e Kursimeve Pensionale kur ta arrijnë moshën e pensionimit", ka thënë Kusari-Lila. Në qershor të vitit të kaluar, përkundër debateve, propozimi për tërheqjen e kursimeve pensionale nuk kaloi.

PSD-ja zëvendëson flamujt para MPJD-së me kartëmonedhën 500-euroshe me fytyrën e ambasadorit Berishaj



Prishtinë, 16 janar - Partia Socialdemokrate (PSD) ka mbajtur një aksion simbolik te Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD). Ky aksion është mbajtur për shkak të dyshimeve për përfshirjen e ambasadorit të Kosovës në Kroaci, Martin Berishaj, në afëra milionëshe. Me këtë rast, aktivistët e PSD-së para MPJD-së kanë ndërruar flamujt duke vendosur kartëmonedhën me 500 euro me fytyrën e ambasadorit Martin Berishaj.

"Martin Berishaj, flamuri i skandalit. Martin Berishaj s'po del të jetë ambasador. Ai është tregtar i mafisë së energjisë së Ballkanit me petkun e ambasadorit. Pushtetit ia vendosëm flamujt e Martin Berishajt, personifikimit të korrupsionit. Skandali i ambasadorit të Kosovës në Kroaci është skandali më i madh në Kosovë. Por, presidentja e kryeministri e mbrojtën. Ministrja e Punëve të Jashtme bile e shfajësoi; e njoh, tha, prandaj s'mund të jetë i fajshëm. Është e

qartë që pushteti në Kosovë është i ndërlidhur drejtpërdrejt me z. Berishaj. Është, po ashtu e qartë, që Martin Berishaj i ka fshehur bizneset e veta tek autoritetet e Kosovës. Ai nuk e ka deklaruar pasurinë e tij. Për këtë duhet të japë përgjigje para prokurorisë. Por, mbi të gjitha, ai dhe pushteti bashkë me të duhet të japin përgjegjësi politike për këtë skandal të përmasave ballkanike", u tha gjatë aksionit të PSD-së. Ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, e

pyetur nga gazetarët për rastin e ambasadorit të Kosovës në Kroaci, Martin Berishajt, ka thënë se deri në këto momente nuk ka asnjë informacion zyrtar se Berishaj ka bërë ndonjë shkelje. "Unë kam kërkuar dhe vazhdoj të kërkoj nga shtetet të cilat janë përmendur që të na japin informacione se a janë të vërteta apo spekulime të medieve të ndryshme akuzat ndaj tij. Ambasadori nuk shkarkohet për shkak të spekulimeve mediale. Ai shkarkohet kur ka arsye faktike",

ka thënë ministrja Gërvalla. Nënkyetarja e PDK-së, Vlora Çitaku, ka komentuar deklaratën e ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla. Çitaku ka shkruar në "Facebook" se Martin Berishaj duhet të kthehet në Kosovë dhe të përballet me drejtësinë. "Shkarkimi nuk mjafton, Ministre! Miliona euro në kesh nuk janë fjalë. Martin Berishaj duhet të kthehet në Kosovë dhe të përballet me drejtësinë. Menjëherë!", ka shkruar Çitaku.

Haradinaj: Punën e mirë të Smajl Latifit e vlerësojnë institucionet vendore dhe ndërkom-

RAHOVEC, 16 JANAR - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, është takuar me kryetarin e Rahovecit, Smajl Latifi, me të cilin kanë biseduar për qeverisjen lokale në këtë komunë. "Sot kisha nderin ta

takoj kryetarin Latifi dhe ekipin e tij të suksesshëm, të cilët po na bëjnë krenarë me sukseset e arritura, duke dhënë shembullin e një qeverisjeje të mirë në dobi të qytetarit", ka shkruar

Haradinaj në "Facebook". Ai ka thënë se institucionet më kredibile, vendore dhe ndërkombëtare, tanimë vlerësojnë punën e mirë të kryetarit Smajl Latifi në transparencë dhe në efikasitet

në qeverisje. "Kjo performancë e mirë në qeverisje nuk është rastësi, pasi që Rahoveci shquhet për traditën dhe njerëzit e saj të devotshëm të punës", ka theksuar Haradinaj.



Reagim i KMDLNj-së

Strategji e gabuar për hulumtimin e krimeve të luftës në Kosovë

Më 15 janar 2023 u përkujtuan 45 viktima civile të fshatit Reçak që u ekzekutuan nga forcat policore dhe ushtarake të Serbisë më datë 15 janar 1999. Ruzhdi Jashari, në atë kohë e informoi zyrën e KMDLNj-së në Prishtinë për këtë krim të tmerrshëm pa e ditur numrin e saktë të viktimave pasi që ishte informata e parë. Më 16 janar 1999 anëtarë të KMDLNj-së ishin në Shtime afër rrugës për Reçak e cila ishte e bllokuar nga Policia serbe dhe dëgjoheshin të shtëna me armë ndërkaq, e shoqëruar nga policë të shumtë serbë, Danica Marinković kishte dalë në terren për të ndërtuar arsyetim për këtë krim të pashembullt që e bëri shteti serb kundër civilëve shqiptarë. Dëshmitarët që dëshmuuan para Tribunalit të Hagës, bashkë me komandantin e Zonës, Shukri Buja, para se të shkonin në Hagë ishin në Zyrën e KMDLNj-së në Prishtinë për konsultime dhe pajisje me dëshmi. Masakra e Reçakut ishte kryer thuaja pa dëshmitarë prandaj ishte e vështirë të sigurohen dëshmitarë okularë dhe të besueshëm për të dënuar kryerësit e krimit. Me kalimin e kohës kjo mundësi po bëhet edhe më e vogël andaj KMDLNj, edhe për këtë por edhe për rastet tjera ka kërkuar që rastet të ndiqen në bazë të përgjegjësisë politike, policore dhe ushtarake, sipas përgjegjësisë komanduese për të gjithë ata që e kanë planifikuar, e kanë urdhëruar apo nuk e kanë penguar krimin e që e kanë pasur atë mundësi por edhe detyrim. Tash, në mungesë po ndiqen 18 persona, policë dhe serbë lokalë e që nuk garanton drejtësi për viktimat për faktin se kryesorët nuk janë të qasshëm për drejtësinë ndërsa gjykimi në mungesë, nga aspekti i të drejtave të njeriut është lehtë i cenueshëm. Bartësit



e posteve kryesore, kryeministri, presidentja dhe kryekuendari premtojnë drejtësi për viktimat që, në rrethana aktuale është shumë e vështirë të materializohet aq më parë që janë bisedimet për normalizim të marrëdhënieve me Serbinë dhe bashkësia ndërkombëtare nuk është e interesuar të hapë çështje të ndjeshme sikur që janë krimet e luftës. Në këtë përkujtim të Masakrës së Reçakut, politikanët e bënë punën e tyre duke bërë përpjekje ta marrin kurorën e lavdisë ndërsa, më të merituarit që e bënë luftën, ish-luftëtarët e UÇK-së, familjet e dëshmorëve dhe heronjve të kombit si dhe të viktimave civile të luftës mbetën në margjinë. Madje, për luftën në atë kohë nuk mund të flasin

politikanët që, për shkak të moshës apo bindjeve politike nuk ishin pjesë e luftës, qoftë edhe si spektatorë por duhet të flasin ata që e bënë luftën e që në këtë përkujtim ishin shpërfillur nga politika. Nëse është i vërtetë pohimi i disa portaleve se teksti i kryetarit të Reçakut ishte redaktuar duke mos lejuar të përmenden emrat e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit, Rexhep Selimit, Nasim Haradinajt, Hysni Gucatit dhe Salih Mustafës, dhe se edhe UÇK-ja duhet të mos përmendet, e këto ishin edhe pohimet e shoqatave të dala nga lufta atëherë KMDLNj propozon që këto manifestime të ndërpriten në mënyrë që të mos manipulohen dhe keqpërdoren nga askush, për qëllime politike

dhe të tjera. KMDLNj, edhe më herët pati propozuar që të mbahet një manifestim Qendror, Dita e Përkujtimeve në nivel vendi që do të ishte një Orë e Historisë ku nxënësit, studentët dhe qytetarët do t'i vizitonin vendet ku prehen në përjetësi krijuesit e lirisë dhe të këtij shteti që e kemi, ashtu si e kemi. Fjalën kryesore do ta kishin bartësit e luftës, viktimat dhe kategoritë e dala nga lufta ndërsa politikanët, cilitdo qofshin ata, do ta kishin një prani dhe rol simbolik. Kosova, në planin e hetimit dhe gjykimit të krimeve të luftës duhet të insistojë në ndjekjen në bazë të përgjegjësisë komanduese politike, policore dhe ushtarake e jo të merret me raste të izoluar, vështirë të dëshmueshme prandaj edhe kemi aq pak të

dënuar për krime lufte. KMDLNj po e vëren një zbutje të qëndrimeve në këmbënguljen për gjykimin e krimeve të luftës dhe ka frikë se për shkak të përshtatjes së rrethanave, shumica e viktimave do të pamundësohen të realizojnë njëherë ndër të drejtat elementare të njeriut, të drejtën për drejtësi dhe për t'u informuar që janë edhe dy shtyllat e Drejtësisë Tranzicionale në kohën kur jemi afër hartimit të Strategjisë Kombëtare për Drejtësi Tranzicionale. Sipas të drejtës ndërkombëtare, krimet e luftës nuk mund të falen e as të vjetërsohen por, një marrëveshje ndërkombëtare politike i relativizon ato shumë duke i shndërruar në "falje të heshtur". A po ndodh kjo në Kosovë?!

Kurti merr pjesë në Forumin Ekonomik Botëror në Davos

PRISHTINË, 16 JANAR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti ka udhëtuar të hënën për në Zvicër për të marrë pjesë në Forumin Ekonomik Botëror në Davos. Në ditën e parë të qëndrimit në

Zvicër, kryeministri Kurti, së bashku me ministren e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, shefin e stafit, Luan Dalipi, këshilltarin politik për Teknologji të Informacionit, Lulëzon Jagxhiu dhe

këshilltaren politike të ministrit të Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Gearda Demiraj, do të jenë folës në Samitin e Investitorëve në Cyrih (Zürich) të organizuar nga Qeveria e Kosovës.



Shqipëria nderon me medaljen “Kalorësi i Urdhrit të Flamurit” William Walkerin

TIRANË, 16 JANAR - Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, e ka nderuar ambasadorin William Walker me medaljen “Kalorësi i Urdhrit të Flamurit”. Begaj ka thënë se ambasadori Walker është shembull dhe mbrojtës i jetës, lirisë dhe prosperitetit të qytetarëve të Kosovës, të rajonit e të kombit tonë. “Nderova sot në emër të shtetit shqiptar dhe të gjithë shqiptarëve, me një nga medaljet më të larta të Republikës së Shqipërisë, atë të ‘Kalorësit të Urdhrit të Flamurit’, ambasadorin William G. Walker. Ambasadori Walker është një personalitet ndërkombëtar, diplomat dhe humanist, i pari që ekspozoi në mbarë botën si ‘një krim kundër njerëzimit’ masakrën e Reçakut, ku u masakruan dyzet e pesë qytetarë të pafajshëm nga trupat ushtarake dhe parashtarake të regjimit të Millosheviqit, gjë që solli reagimin e menjëhershëm të komunitetit ndërkombëtar”, ka thënë presidenti Begaj.

Ai ka shtuar se për të mos haruar krimet e së shkuarës si edhe në sfondin e agresionit të pajustificuar rus në Ukrainë, për



ta ruajtur paqen dhe për t'u lënë një botë më të mirë fëmijëve

tanë, vlerësojnë personalitete si ambasadori Walker, shembull

dhe mbrojtës i jetës, lirisë dhe prosperitetit të qytetarëve të

Kosovës, të rajonit e të kombit tonë.

Ngrihet aktakuzë për mashtrimin e mbi 40 klientëve në vlerë mbi 44 mijë euro



PEJË, 13 JANAR - Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit E. B. për shkak se ka kryer veprën penale “Mashtrimi” nga neni 323, paragrafi 1, lidhur me nenin 77 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Sipas aktakuzës, i pandehuri E. B., nga data 27 korrik 2022 në vazhdimësi gjer me datë 14 shtator 2022 në agjencinë e tij turistike në Pejë,

duke paraqitur fakte të rreme me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, fillimisht ka mashtruar disa klientë me bileta udhëtimi në drejtim të Turqisë e me këtë nxitë edhe shumë persona të tjerë të kryejnë një veprim të tillë në dëm material të pasurisë së tyre, kinse ka aranzhuar bileta të udhëtimit dhe aranzhime në hotelet për pushime verore në Turqi e me këto veprime i vë në

lajthim mbi 40 viktima të cilëve u shkaktohet dëm material në vlerë mbi 44 mijë euro.

Prokurori i çështjes, me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar gjykatës që i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit për veprën penale e cila i vihet në barrë. I pandehuri nga muaji tetor i vitit të kaluar, me kërkesë të Prokurorisë Themelore të Pejës, gjendet në paraburgim.

“Handikos”-i ofroi mbi 700 pajisje ndihmëse në vitin

EPOKA
ERE


Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 16 JANAR - Shoqata e Paraplegjikëve dhe Paralizës së Fëmijëve të Kosovës “Handikos” përgjatë vitit 2022 me përkushtim ofroi shërbimin e pajisjeve ndihmëse për personat me aftësi të kufizuara dhe të gjithë qytetarët e Kosovës në nevojë.

Vetëm përgjatë vitit që lamë pas nga Qendra e Resurseve të “Handikos”-it në Prishtinë janë ofruar mbi 700 pajisje të

ndryshme që shërbejnë për lëvizje të lirë, prej tyre 50 për qind ishin karroca, pastaj paterica, shëtitore, shtretër ortopedikë etj. “Handikos”-i gjatë asaj periudhe ka ofruar edhe shërbime të tjera si në vijim: 74 fëmijë me aftësi të kufizuara përfitues të shërbimeve ditore/javore; 1 748 seanca individuale fizioterapeutike, psiko-sociale, psikologjike, ergoterapeutike dhe edukim joformal; 292 seanca individuale fizioterapeutike dhe psiko-sociale për fëmijë me aftësi të kufizuara në terren; 34

prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara, përfitues të shërbimit psiko-social; mbi 300 këshillime ligjore, takime mbështetëse, referime, vizita në shtëpi, shërbime për jetesë të pavarur, mirëmbajtje të pajisjeve ndihmëse për persona me aftësi të kufizuara dhe familjarë të tyre. “Handikos”-i ka njoftuar se duke u bazuar në misionin dhe vizionin e saj, por edhe në kuadër të implementimit të projekteve, do të vazhdojë të shërbejë çdoherë për personat me aftësi të kufizuara dhe jo vetëm.



Murati: Reforma e skemave sociale dhe pensionale është e domosdoshme

PRISHTINË, 16 JANAR - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka thënë se reforma për skemat sociale dhe pensionale është e domosdoshme. Ai ka bërë me dije se kjo reformë është e nënshkruar nga Qeveria e Kosovës me Bankën Botërore. Në këtë kontekst,

Murati ka kërkuar që kjo reformë të jetë ndër punët e para të qeverisë. "Reforma e skemave sociale dhe pensionale është e domosdoshme. Kjo reformë mundësohet nga marrëveshja që ne si qeveri e kemi nënshkruar me Bankën

Botërore, marrëveshje e cila tashmë ka muaj që pret dritën e gjelbër nga Kuvendi i Republikës. Shpresoj që një nga punët e para që do të bëjë Kuvendi në sesionin e ri të jetë ratifikimi i kësaj marrëveshjeje", ka shkruar në "Facebook".



Kosovë, sfidat e zhvillimit ekonomik në vitin 2023

PRISHTINË, 16 JANAR - Njohës të fushës së ekonomisë në Kosovë thonë se një marrëveshje përfundimtare për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë do t'i shmangte krizat e ngjashme me ato të fundvitit të kaluar në veriu e vendit që lanë pas vetes pasojat negative në aspekte të ndryshme ekonomike, posaçërisht në nxitjen e investimeve të huaja. "Një sfidë që ne e shohim dhe urojmë të mos ndodhë është përsëritja e krizave të mundshme në aspektin e sigurisë siç i kemi parë në fund të vitit 2022 meqë ato pastaj ndikojnë edhe në gjendjen e përgjithshme edhe sa i përket konsumit e nivelit të besueshmërisë që qytetarët mund të kenë në përgjithësi, por edhe në imazhin e vendit karshi investitorëve të jashtëm, por edhe nxitjen ose pengimin e investimeve të jashtme", tha në një bisedë me "Zërin e Amerikës", kryetari i Odës Ekonomike Amerikane, Arian Zeka. "Fundviti na gjeti me një problem tjetër, me një sfidë tjetër që ishte në Mitrovicë dhe që ndikoi edhe te biznesi, sidomos tek aspekti i investitorëve, sepse Serbia në këtë drejtim kujdeset shumë mirë që të krijojë sa më shumë negativitet për Kosovën dhe pasiguri, ndërkohë që siguria ekziston në Kosovë për investime", thotë Skender Krasniqi nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë. Zeka thotë se përmbyllja e marrëveshjes përfundimtare me Serbinë dhe rrjedhimisht eliminimi i krizave të brendshme do të pasqyronin



qëndrueshmëri për investitorët e mundshëm të huaj në Kosovë. "Për shkak se në rastin tonë një çështje e tillë e pazgjidhur natyrisht se ndikon edhe në aftësinë tonë për t'i bindur investitorët seriozë që të vijnë dhe të investojnë në Kosovë. Investitorët e sidomos kompanitë e mëdha globale përgjatë analizave të tyre natyrisht që marrin parasysh faktorët politikë dhe çështjet e hapura të politikës së jashtme të Kosovës në këtë rast na pamundësojnë që t'i bindim investitorët seriozë që të vijnë", thotë ai. Nxitja e investimeve të huaja në Kosovë vlerësohet një nga sfidat ekonomike për vitin 2023 krahas problemeve me shkallën e lartë të inflacionit të nxitur nga agresioni rus në Ukrainë. Ekspertët thonë se kriza

ekonomike në vend pritet të vazhdojë edhe këtë vit, me gjithë parashikimet se shkalla e inflacionit pritet të bie nga fundi i vitit apo fillimi i vitit të ardhshëm. "Ajo çfarë mund të presim të shohim edhe më tej është një vazhdim i normave të larta të inflacionit edhe përgjatë vitit 2023, sidomos në tre çerekmuajt e parë të vitit, pastaj ndoshta një fillim të stabilizimit të çmimeve nga fundi i këtij viti dhe, ndoshta, rregullim të plotë në fillim të vitit 2024. Kjo mund të jetë një nga sfidat më të mëdha, sfida pra e kostos së lartë të jetesës me të cilën qytetarët e vendit janë përballur edhe përgjatë vitit të kaluar", thotë zoti Zeka. Pasojat e kësaj situatë do të pasqyrohen në aspekte të ndryshme të ekonomisë së vendit, thotë ai. "Kjo pastaj ndikon edhe në fuqinë blerëse, në qarkullimin e

bizneseve, në aftësinë e tyre për t'i ruajtur vendet e punës, aftësinë e bizneseve për t'i paguar detyrimet ndaj shtetit dhe, rrjedhimisht, edhe në aftësinë e shtetit për të mbledhur të hyra buxhetore. Kjo pastaj mund të përkthehet në më pak shërbime publike, në më pak investime kapitale, gjë që ndoshta në rrethana të tjera në këtë vit nuk bën dallim sepse edhe në vitin e kaluar investimet kapitale të zbatuara nga ana e shtetit kanë qenë në minimum, kështu që shpresojmë që së paku në këtë aspekt do të kemi një përmirësim gjatë vitit 2023", thotë ai. Kryetari i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, Skender Krasniqi, i tha "Zërit të Amerikës" se qeveria duhet t'i përqendrojë politikat e saj në rritjen e prodhimit vendor për

ta ulur shkallën e inflacionit e cila është pasojë e trendeve globalë dhe prek më shumë vendet me import të lartë si Kosova. "Shpresojmë që qeveria, meqë ka buxhet më të mirë se në vitet e kaluara, do të investojë më shumë në prodhimin vendor dhe në krijimin e klimës dhe ofertave për të investuar në Kosovë në mënyrë që të kemi rritje dyshifrore", tha ai. Banka Botërore në një raport të publikuar të martën mbi ekonominë globale ka parashikuar që Kosova do të ketë rritjen më të madhe ekonomike në rajon në vitin 2023, përkatësisht 3.7 për qind. Por, sipas të dhënave të këtij raporti gjatë vitit 2021, prodhimi i brendshëm i Kosovës vazhdoi të jetë më i ulëti në rajon, saktësisht 5 mijë e 269 dollarë për kokë banori.

OKB-ja: Ngadalësimi ekonomik do t'i shtyjë punëtorët në punë më të këqija

NJU-JORK, 16 JANAR - Ngadalësimi ekonomik global do t'i detyrojë më shumë punëtorët të pranojnë punë që paguhen më pak më 2023, kanë paralajmëruar të hënën Kombet e Bashkuara. Teksa çmimet rriten më shumë sesa të hyrat, kriza e kostos së jetesës është duke

shtyrë më shumë njerëz drejt varfërisë, ka thënë Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Punë Ndërkombëtare. Sipas saj, niveli i papunësisë në botë pritet të rritet. Si shkaqe për një situatë të tillë është përmendur lufta e Rusisë në Ukrainë, tensionet gjeopolitike dhe rimëkëmbja

nga pandemia e koronavirusit. "Së bashku ato kanë krijuar kushte për inflacion të lartë dhe rritje të ulët ekonomike - për herë të parë prej vitit 1970", ka thënë agjencia në raportin e saj vjetor. Vendet më të prekura, sipas të dhënave, janë ato me të hyra të ulëta dhe të mesme.



Çfarë efekti ka rrëmuja mbi trurin e njeriut?



Ka nga ata që punojnë të qetë vetëm mbi një tavolinë të pastër dhe në dhoma me një mobilim minimal. Por ka të tjerë që jetojnë të rrethuar nga një grumbull i madh letrash, librash dhe orendish. Por a mund të ndikojë mjedisi i jashtëm në performancën e trurit tonë?

A mundet që rrëmuja në shtëpi apo zyrë të jetë “kreative” apo t’i ngatërrojë idetë tona?

Kërkimet shkencore bien kryesisht dakord me Mari Kondo, gurinë japoneze të artit të rregullimit, e cila rregullon dollapët, qilarët dhe shtëpitë me një saktësi kirurgjikale. Aq sa Elizabet Sander, psikologe në Universitetin Bond në Australi, ka treguar se rendi, bukuria dhe mungesa e kaosit në mjedisin ku punojmë, lidhet me përgjigjet më të mira njohëse dhe emocionale të sistemit tonë nervor.

“Trurit nuk i pëlqen çorganizimi, pasi i shteron burimet e tij dhe e zvogëlon aftësinë për t’u

përqendruar. Tufat e letrave, gotat e pista, objektet e hedhura me shumicë në tavolinë e shpërqendrojnë mendjen tonë, krijojnë një lloj mbingarkese informacioni vizual, e cila e komprometon kujtesën funksionale” - thotë ajo.

Ndikimin tek produktiviteti dhe qartësia e mendimit, e konfirmon edhe një studim i Institutit të Neuroshkencës të Universitetit Princeton, SHBA. Ai analizoi aktivitetin e trurit të disa vullnetarëve në mjedise pak a shumë të rrëmujshme në shtëpi dhe punë.

Një nga ekspertët, Stefani Mekmein, zbuloi se rregulli rreth e rrotull, e bën trurin tonë më të aftë për të qenë i përqendruar dhe në përpunimin e informacionit, me një përfitim të qartë mbi performancën e aftësive njohëse. Si të mos mjaftonte kjo, një mjedis i çorganizuar dhe kaotik, shkakton

shumë shtyrje të detyrave: ata që kanë një tavolinë të mbushur me letra dhe dosje të hedhura sa andej-këtej pa ndonjë një kriter të saktë, priren të zvarritin më shumë punët që kanë nëpër duar se sa ata që punojnë me skedarëve të radhitur sipas përparësisë.

“Çorganizimi dhe tendenca për të zvarritur punën kanë një origjinë të përbashkët. Të vendosësh gjërat në rregull kërkon kohë, dhe është diçka që nuk e pëlqejnë shumë” - thotë Xhozef Ferrari, profesor i psikologjisë në Universitetin DePaul në Çikago. Sipas tij ata që janë më të çrregullt priren t’i shtyjnë punët e tyre, madje janë edhe më të pakënaqur me performancën e tyre.

Duket se efekti negativ në tru i rrëmujës së mjediseve, varet nga stresi i shkaktuar nga kaosi: na pëlqen apo jo, një dhomë e rrëmujshme na vë në alarm në mënyrë të pandërgjegjshme. Rritet

niveli i hormonit të stresit, kortizolit, me një efekt edhe më të dukshëm tek femrat, diçka që varet ndoshta edhe nga trashëgimia kulturore.

“Gratë ndihen shpesh përgjegjëse për rendin e gjerave, dhe kur dështojnë përjetojnë shqetësim më të madh” - thotë Darbi Saksbi, psikologe në Universitetin e Kalifornisë Jugore, që ka studiuar efektet e rrëmujës tek norma e stresit.

E gjithë kjo ka pasoja jo vetëm në aktivitetin e aftësive njohëse, që përkeqësohet, por edhe tek mirëqenia në përgjithësi. Kështu disa studime tregojnë se gjumi në dhoma të rrëmujshme e lehtëson fillimin e çrregullimeve të gjumit, duke e bërë më të vështirë rënien në gjumë apo nxit ëndrrat e këqija. Por një mjedis i rrëmujshëm, mund të vërë në provë edhe marrëdhëniet personale, sepse sipas të dhënave të mbledhura nga studiuesit e

Departamentit të Psikologjisë të Universitetit Kornell të SHBA-së, kaosi e pengon interpretimin e saktë të shprehjeve dhe emocioneve të njëri-tjetrit, duke shkaktuar më shumë grindje dhe diskutime.

Për më tepër, të tjerët na gjykojnë pikërisht në bazë të organizimit të hapësirave tona. Një studim amerikan nga Universiteti i Miçiganit, ka treguar se hyrja në një zyrë të rregullt (librat në rafta, letrat e mirë-sistemuara, mbeturinat në kosh), nxit gjykimin e personit në fjalë si më të ndërgjegjshëm dhe më të besueshëm, sa se ata që punojnë në një hapësirë të paorganizuar (me librat në dyshe, letra e shpërndara etj). Me pak fjalë, pamja ka rëndësinë e saj. Përshtypja, shpjegojnë autorët e hulumtimit, është se kemi të bëjmë me një person të pakujdesshëm, më nervoz dhe më të vështirë për t’u menaxhuar. / Focus – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Tre vëllezërit boksierë nga Gjakova synojnë t'i sjellin Kosovës medalje ndërkombëtare

Sali, Hykber dhe Leotrim Hajdaraj janë vëllezërit nga komuna e Gjakovës që merren me sportin e boksit, derisa janë pjesë e Klubit të Boksit "Sport Center". Ata kanë filluar t'i renditin sukseset në rrafshin vendor, derisa synim kryesor kanë t'i sjellin Kosovës medalje nga garat ndërkombëtare

EPOKA ERE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 16 JANAR - Sportistët nga qyteti i Gjakovës shpeshherë kanë lënë gjurmë në sportin vendor, por edhe në atë ndërkombëtar. Një gjë të tillë pritet ta bëjnë edhe tre vëllezërit boksierë Sali, Hykber dhe Leotrim Hajdaraj të cilët kanë filluar t'i renditin sukseset në rrafshin vendor, derisa synojnë që në të ardhmen t'i sjellin Kosovës medalje edhe nga garat ndërkombëtare.

Boksieri Sali Hajdaraj nga fshati Devë e komunës së Gjakovës bashkë me vëllezërit e tij Hykberin dhe Leotrimin stërviten në Klubin e Boksit "Sport Center". Salihi është shpallur nënkampion në

Kampionatin Individual të Kosovës në vitin që sapo lamë pas. "Me sportin e boksit merrem që një vit. Sportin e boksit e fillova në moshën 16 vjeçare. Stërvitem nga trajnerët Leonard Hoxha, Lekë Ramoja dhe Agim Shala, të cilëve u jam shumë mirënjohës për përkushtimin dhe mundin e tyre të palodhshëm. Në stërvitimi pesë herë në javë, nga dy orë dhe dy herë në ditë. Gjatë këtij viti unë zhvillova pesë meçe, ku në këto meçe nuk ishte dhe aq lehtë, por ia arrita t'i përmbyllë me sukses. Në meçin e fundit në Kampionatin Individual të Kosovës arrita të bëhem nënkampion i Kosovës, por për vitin 2023 kam pritshmëri më të mëdha, sepse në vitin 2023 pres të



zhvilloj më shumë ndeshje e t'i sjell më shumë medalje qytetit tim. Gjithashtu një ndër pritshmëritë më të mëdha është edhe përfaqësimi i Kosovës që të sjell medalje evropiane, pse jo edhe botërore", ka thënë Sali Hajdaraj.

Djaloshi tjetër nga familja Hajdaraj nga Deva që merret me sportin e boksit është Hykberi. Edhe ky ka pasur një vit të suksesshëm. "Gjatë këtij viti kam zhvilluar shtatë meçe. Të gjitha i kam përmbyllur

me sukses, po ashtu në dy meçet e fundit në Kampionatin Individual të Kosovës boksova në gjysmëfinale dhe në finale ku nëpërmjet këtyre ndeshjeve arrita të bëhem kampion i Kosovës për vitin 2022/2023 në peshën 54 kg, ndërsa në vitin 2023 pres ta përfaqësoj Kosovën edhe në garat ndërkombëtare, pse jo të sjell edhe medalje", ka deklaruar Hykberi Hajdaraj.

Leotrimi është vëllai i tretë që merret me boks. Ai është 15-vjeçar

dhe thotë se vëllezërit e tij janë motivi kryesor që merret me këtë sport dhe synon të ecë hapave të tyre dhe të jetë një sportist i suksesshëm. "Me sportin e boksit merrem që nga viti i kaluar. Motivin dhe dëshirën për boks i mora pas sukseseve dhe arritjeve të vëllezërve të mi Sali dhe Hykber Hajdaraj. Ata më motivojnë të stërvitem dhe shpresoj të shkoj hapave të tyre dhe ta bëj krenar shtetin tim", ka shtuar Leotrimi. Vëllezërit Hajdaraj nga Deva sukseset ia dedikojnë kryetarit të Klubit të Boksit "Sport Center" në Gjakovë, Halil Kurhasku dhe trajnerëve Leonard Hoxha, Lekë Ramoja dhe Agim Shala. "Një faleminderit i veçantë shkon edhe për familjen tonë Hajdaraj, e cila nuk kurseu mbështetjen, në veçanti një falënderim i veçantë është për prindin Besim Hajdaraj i cili është krah nesh që nga hapat e parë të fillimit të karrierës sonë", kanë deklaruar vëllezërit boksierë nga Gjakova.

Zëvendësministrja Osmani pret delegacionet e KO të Francës, Shqipërisë dhe Malit të Zi

PRISHTINË, 16 JANAR - Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) është duke mirëpritur delegacionet e Komiteteve Olimpikë të Francës, Shqipërisë dhe Malit të Zi, të cilat, bashkë edhe me KO të Maqedonisë së Veriut, kanë nënshkruar memorandumimin e bashkëpunimit "Balkan Cooperation 5".

Delegacionet, të shoqëruar nga drejtuesit e lartë të KOK-ut, janë pritur nga zëvendësministrja për Kulturë, Rini e Sport, Daulina Osmani. Zëvendësministrja Osmani i falënderoi delegacionet



për vizitën dhe bashkëpunimin e mirë me KOK-un, derisa foli për sfidat dhe sukseset e sportit tonë, me

theks të veçantë mbështetjen për KOK-un dhe federatat sportive si dhe hartimin e strategjisë për

sportin. Zëvendës-presidenti i KO të Francës, Pierre Siutat, u shpreh i lumtur që ndodhej në Kosovë, për të nisur një bashkëpunim mes KO të Kosovës, por edhe komiteteve të tjera olimpikë fqinje. Presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi, duke falënderuar zëvendësministren për takimin, e quajti ditë historike nënshkrimin e memorandumit të bashkëpunimit me Francën, duke thënë se bashkë me KO fqinje do të rrugëtojnë drejt Paris 2024. I pari i lëvizjes olimpikë në Shqipëri, Fidel Ylli, vlerësoi lart

projektin e përbashkët, duke thënë se Kosova tashmë njihet më shumë për nga sporti, ndërsa përmendi edhe projektin gjigant në vlerë 5 milionë eurosh të fituar nga qeveria shqiptare për shkollat. Sekretari i përgjithshëm i KO të Malit të Zi, Igor Vushuroviq, theksoi se ky bashkëpunim na lidh edhe më shumë mes vete, derisa vlerësoi lart punën e KOK-ut dhe mbështetjen e MKRS-së. Palët diskutuan edhe për përgatitjet për Lojërat Olimpikë "Paris 2024", në të cilat pikërisht KO i Francës është mikpritës.

Zërina Shatri, MVP e xhiros së 12-të

PRISHTINË, 16 JANAR - Në fundjavë është zhvilluar xhiro e 12-të e Superligës së Femrave. Ndeshja më interesante e kësaj xhiroje u zhvillua në kryeqytet mes Prishtinës dhe Trepçës, ku triumfuan vajzat bardhë e kaltër me rezultat 67:58. Më e mira e kësaj xhiroje dhe ndeshjes ishte qendra Zërina Shatri, e cila kontribuoi me 19 pikë, 13 kërcime dhe katër asistime. Ajo u tregua e

saktë 9/14 për dy pikë dhe 1/1 nga gjuajtja e lira. Në këtë përballje u dallua edhe Sarah Mgbeike me 16 pikë, 14 kërcime dhe katër asistime. Lideri Bashkimi arriti fitore të lehtë ndaj United Basketballit me rezultat 32:66, për të vazhduar serinë pozitive, ku më e mira ishte Dasiva Evnas, e cila realizoi 16 pikë, shtatë kërcime dhe katër asistime. Fitore arriti edhe Penza në udhëtim te

TOP PESËSHJA

Zërina Shatri (Prishtina) 19 pikë, 13 kërcime, 4 asistime
Saranda Daci (Penza) 20 pikë, 17 kërcime, 6 asistime
Jeta Zeka (Penza) 18 pikë, 9 kërcime, 5 asistime
Sarah Mgbeike (Prishtina) 16 pikë, 14 kërcime, 4 asistime
Dasiva Evans (Bashkimi) 16 pikë, 7 kërcime, 3 asistime

Vëllaznimi me rezultat 50:88, ku më të mirat e kësaj ndeshjeje ishin Saranda Daci me 20 pikë, 17 kërcime

dhe gjashtë asistime, si dhe Jeta Zeka me 18 pikë, nëntë kërcime dhe pesë asistime.



Kosova U17, e gatshme për kualifikueset e Evropianit

PRISHTINË, 16 JANAR - Përfaqësuesja U17 e Kosovës në volejboll po kryen të gjitha përgatitjet e duhura para kualifikueseve të Kampionatit Evropian U17

të cilat do të zhvillohet mes datave 18-22 janar në Ankara të Turqisë. Kosova është pjesë e Grupit B, së bashku me Rumaninë, Bullgarinë dhe Moldavinë.

Ekipi U17 i Kosovës do të niset sot (e martë) në mëngjes drejt kryeqytetit turk ku do t'i vazhdojë përgatitjet para ndeshjes së parë. Vashat e Kosovës më 18

janar përballen me Rumaninë, kurse një ditë më vonë përballen me Bullgarinë, ndërsa me datën 20 janar përballen me Moldavinë.



Paqarada nënshkruan për Kolnin

KOLN, 16 JANAR - Leart Paqarada do të jetë pjesë e Kolnit në Bundesligë nga sezoni i ardhshëm. Futbollisti i Përfaqësueses së Kosovës që aktualisht është pjesë e St. Paulit në Bundesliga 2, ka firmosur një kontratë trevjeçare

me Kolnin. Kjo lëvizje e Kolnit në merkato vjen edhe prej faktit se në fundin e këtij sezoni do të tërhiqet nga futbolli i luajtur kapiteni Jonas Hector dhe Paqarada që konsiderohet si një nga më mbrojtësit e majtë më të spikatur në

Bundesliga 2, është përzgjedhur nga drejtuesit e gjermanëve për ta zëvendësuar 32-vjeçarin. Paqarada ka një karrierë të ndërtuar në Gjermani teksa 28-vjeçari e ka nisur me të rinjtë e Werder Bremenit për të kaluar më pas

te të rinjtë e Leverkusenit dhe më pas në Sandhausen. Gjithsesi, tashmë vjen hapi më i madh i karrierës për lojtarin e Kosovës, teksa aktualisht Kolni renditet në vendin e 13-të me 17 pikë dhe pritet të luftojë deri në fund për qëndrimin në elitë.



Dallohet në derbi, Wilsoni shpallet MVP

PRISHTINË, 16 JANAR - Në fundjavë u zhvillua xhironja e 18 në Prince Caffë Superligën e Kosovës në basketboll. Derbin e rivalëve të vjetër në mes të Trepçës dhe Sigal Prishtinës e fituan bindshëm prishtinasit. Te bardhekaltrit më i miri ishte Derrick Wilsoni me 15 pikë, katër kërcime, dhjetë asistime, si dhe tre topa të vjedhur, ndërsa për tri pikë ishte i saktë tri herë nga tri tentime dhe për dy pikë, tri herë nga pesë tentime. Wilsoni me këtë paraqitje u shpall MVP i javës. Ai u ndihmua nga Brooks Debisschop që, po ashtu, kishte dyshifror të dyfishtë me 15 pikë e 14 kërcime dhe një asistim. Peja u rikthye te fitorja, ku mundi Vëllaznimin në udhëtim, ndërsa më i miri te verdhezinjtë ishte Brad Waldow me 20 pikë, 18 kërcime dhe dy asistime. Golden Eagle Ylli regjistroi fitoren e 13-të me radhë, ku brenda pak ditëve mundi dy herë Ponte Prizrenin, kurse kësaj radhe u dallua amerikani i natyralizuar Malcolm Armstead



TOP PESËSHJA

Derrick Wilson (Sigal Prishtina) 15 pikë, 4 kërcime, 10 asistime
Brad Waldow (Peja) 20 pikë, 18 kërcime, 2 asistime
Brooks Debisschop (Sigal Prishtina) 15 pikë, 14 kërcime, 1 asistim
Malcolm Armstead (Golden Eagle Ylli) 15 pikë, 9 kërcime, 5 asistime
Curtis Jones (Bashkimi) 21 pikë, 5 kërcime, 3 asistime

me 15 pikë, nëntë kërcime dhe pesë asistime. Bashkimi vazhdoi serinë pozitive dhe realizoi fitore shumë të rëndësishme ndaj

Rahovecit, ndërsa më i miri në parket ishte Curtis Jones i prizrenasve me 21 pikë, pesë kërcime dhe tri asistime.

Denveri mbron kreun në Perëndim, Philadelphia mposhti lakersat në sekondën e fundit

DETROIT, 16 JANAR - Denveri mbron kreun e renditjes në Konferencën e Perëndimit pas fitores me rezultat 119-116 ndaj Orlandos, ndeshje ku të gjithë titullarët e nuggetsit realizuan mbi 10 pikë. Gordoni me 25 pikë dhe Jokiçi me një "triple double" (17 pikë, 10 rebounde e 14 asistime) bënë dallimin në fushë. Chicago fitoi me lehtësi me rezultat 132-118 ndaj kampionëve të Golden States, duke hyrë në zonën "play-off". Vuqeviqi realizoi 43 pikë e 13 rebounde, duke i bërë të



pavlefshme 26 pikët e Thompsonit. Philadelphia mposhti në sekondën e fundit lakersat me shifrat 113-112 (Joel Embiid 35 pikë e 11 rebound). Portlandi, falë 40 pikëve të Lillardit, mposhti me rezultat 140-123 Dallasin, ndërsa clippersat

mundën me shifrat 121-100 Houstonin, ndeshje ku u dalluan Mann me 31 pikë e Leonardo me 30 pikë. Mungesa e Durantit ndihet te Brooklyn, që u mund me rezultat 112-102 nga Oklahoma (Gideey e Shai nga 28 pikë secili).

REZULTATET

Detroit - New York	104-117
Clippers - Houston	121-100
Chicago - Golden State	132-118
Brooklyn - Oklahoma	102-112
San Antonio - Sacramento	119-132
Denver - Orlando	119-116
Portland - Dallas	140-123
Lakers - Philadelphia	112-113

SHKURT

Bahtiri përforcon Ulpianën

Futbollisti Kreshnik Bahtiri është bërë me skuadër të re. Në fakt, Bahtiri të hënën është paraqitur në skuadrën e Ulpianës që garon në Ligën e Parë. "Në ambientet e klubit, presidenti i KF Ulpiana, Jeton Gashi, ka arritur marrëveshje me lojtarin elitare Kreshnik Bahtiri për sezonin pranveror të edicionit të garave 2022/2023 me mundësi vazhdimi. Bahtiri në vitet e fundit ka luajtur për ekipet e Superligës, FC Malisheva dhe KF Arbëria, si dhe për ekipin e Superiores së Shqipërisë, KF Kukësi", thuhet në njoftimin e KF Ulpiana.

Januzaj, afër largimit nga Sevilla

Adnan Januzaj pritet të largohet nga Sevilla vetëm gjashtë muaj pasi ka nënshkruar me këtë skuadër. Sulmuesi me prejardhje nga Kosova nuk ka arritur të lë gjurmë në Ramon Sanchez-Pizjuan dhe largimi i tij në janar duket i pashmangshëm. Trajneri argjentinas Jorge Sampaoli i ka bërë të qartë istogasin se nuk është në planet e tij dhe se mund të largohet. Mediet spanjolle kanë raportuar se Januzaj pritet të përfundojë te Valencia, pasi klubi spanjoll ka mbetur pa shërbimet e Samu Castillejos të lënduar. Trajneri Gennaro Gattuso e pëlqen Januzajn dhe ka kërkuar nga drejtuesit e klubit ta afrojnë kosovarin në "Mestalla". Valencia ka nisur kontaktet me Sevilën për huazimin e anësorit dhe zyrtarizimi mund të ndodhë gjatë kësaj jave. Interesim për anësorin kosovar kanë shprehur edhe Evertoni dhe Beshiktashi.

Xavi: Ndaj Realit dominuam nga fillimi e deri në fund

Trajneri i Barcelonës, Xavi Hernandez, është shprehur i lumtur me paraqitjen e lojtarëve që drejton në finalen e Superkupës së Spanjës ndaj Real Madridit (3-1). "Jam shumë i lumtur. Më intereson shumë se si fitojmë. Është e rëndësishme të fitojmë, por duhet të mendojmë si ia dolëm. Ne dominuam nga fillimi deri në fund. Ky ishte plani ynë me katër mesfushorë dhe funksionoi shumë mirë. Jam shumë i lumtur për lojtarët. Kjo skuadër ka marrë shumë kritika të padrejta dhe sot shumë lojtarë e kanë lënë veten të lirë. Ata do të punojnë më me qetësi", ka thënë Xavi.

Anelotti: Mungesë respekti, ata luajtën më mirë se ne

Një poshtërim. Kështu e kanë komentuar disa medie spanjolle humbjen e Real Madridit ndaj Barcelonës në Superkupë. Një term që Carlo Ancelotti nuk i ka pëlqyer. "Është mungesë respekti ta thuash këtë. Ne humbëm kundër Barçës, por e mundëm në ligë. Ata luajtën më mirë dhe e merituan fitoren. Kaq. Është një moment i komplikuar, i vështirë, siç ndodh shpesh në një sezon. Ne duhet të qëndrojmë së bashku. Ky ekip ka cilësitë për të qenë sërish konkurrues. Ka ende një rrugë të gjatë për të bërë. Reali zakonisht fiton finale. Ne do të kthehemi, jam i sigurt", është shprehur Ancelotti për "Movistar".

Nadali e nis me fitore, kualifikohen edhe Gauff, Sakkari e Raducanu

Ka nisur grand slami i Australian Open në tenis teksa në Melburn janë luajtur ndeshjet e para për meshkuj e femra të raundit të parë. Kampioni në fuqi, spanjollli Rafael Nadal, e nisi me fitore aventurën e tij, duke mundur

3-1 (7-5, 2-6, 6-4, 6-1) britanikun Jack Draper. Fiton edhe polaku Hubert Hurkacz (numri 10 në botë), që mposhti 3-0 spanjollin P. Martinez. Nuk zhgënjën italianin Jannik Sinner, që mundi 3-0 britanikun

Edmund, ndërsa kanadezi Denis Shapovalov eliminoi 3-1 serbin Lajoviq. Në raundin e dytë avancojnë edhe rusi Karen Khachanov e amerikani Sebastian Korda. Te femrat tenistja amerikane Coco Gauff mundi 2-0 (6-1, 6-4) çeken K.

Siniakova, ndërsa grekja Maria Sakkari eliminoi kinezin Yan, duke fituar 2-0 (6-1, 6-4). Në raundin e dytë avancojnë edhe amerikanet Jessica Pegula, Daniele Collins e Sophia Kenin. Me sukses e nis këtë aventurë edhe britanikja

Emma Raducanu, që mundi 2-0 gjermanen Korpatsch, ndërsa çekja Barbora Krejçikova eliminoi patrioten e saj Bejlek. Kualifikohen edhe kanadezja Bianca Andreescu, estonezja Julia Ostapenko e çekja Petra Kvitova.



Shqiptarë Humanitare Bëmërisë e Kosovës "Nina Teresa"
The Kosovo Humanitarian and Charitable Society "Mother Teresa"
Humanitarne Dobrotvorne Udruzenje Kosova "Majka Teresa"
10000 Prishtinë Rr. ULPIANA 1/11 p.n. Tel:06131 38 542 864, Fax: 542 869,
Web site: www.matherteresasociety.org e-mail:mterezaj@yahoo.com

CONTRACT AWARD NOTICE SERVICES

According to Article 41 of Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092

Date of the preparation of the Notice: 16/01/2023

Procurement No	Mentoring	003	2023	221
----------------	-----------	-----	------	-----

This notice has been prepared in the LANGUAGES:

English

SECTION I: CONTRACTING AUTHORITY

I.1) NAME AND ADDRESS OF THE CONTRACTING AUTHORITY (CA)

Official name: Kosovo Humanitarian Charitable Society "Mother Teresa"		
Postal address: str. Mujë Krasniqi n.n. Ulpiana U1/1		
Town: Prishtina	Postal code: 10000	Country: Kosovo
Contact point(s): Zef Shala	Telephone: 044-128-277	
Email: zefshala@hotmail.com	Fax: 038-542-865	
Internet address (if applicable):	www.matherteresasociety.org	

SECTION II: OBJECT OF THE CONTRACT

II.1) DESCRIPTION

II.1.1) Contract title attributed by the contracting authority:

Individual consultancy-Mentoring and Coaching for 200 women beneficiaries

II.1.2) Type of contract and location of works, place of delivery or of performance

(Choose one category only - works, supplies or services - which corresponds to the main part of the specific object of your contract)

Services

Main place of performance
All Kosovo according to the
Request of Contracting
Authorities

II.1.4) Short description of the object of the contract

Individual consultancy-Mentoring and Coaching for 200 women beneficiaries

II.1.5) Common Procurement Vocabulary classification (CPV)

93.000.000.-8

II.1.6) Division into lots

NO

II.1.7) Contract value: 59,800.00 Euro

SECTION III: PROCEDURE

III.1) TYPE OF PROCEDURE

Open

III.2) AWARD CRITERIA

Lowest Price

III.3) ADMINISTRATIVE INFORMATION

SECTION IV: AWARD OF CONTRACT

(In case of some parts given to some successful economic operators, repeat S IV.4 and IV.5 for each lot)

IV.1) Date of contract award 16/01/2023

IV.2) Intended date of contract signing 25/01/2023

IV.3) Number of received tenders 4

IV.4) Name and addresses of economic operator to whom the contract has been awarded

Official name: "SMART INOVATION CENTRE"-SIC

Str. Agim Ramadani A3 Prishtinë

Postal address: 10000 Prishtinë

Town: Prishtinë Postal code: 10000 Country: Kosovo

URL (if applicable):

Contact point(s): Saranda Lajqi Email: info@sic-kos.com

Telephone: +383 44/45 817477 Fax: +38338748701

IV.5) Information on value of contract

Total final value of contract 59,800.00 Euro

Responsive tender with lowest price: 59,800.00 Euro

Responsive tender with highest price: 80,000.00 Euro

IV.6) The contract is likely to be subcontracted No

SECTION V: COMPLEMENTARY INFORMATION

V.1) COMPLAINTS

Any interested party may file a complaint with the Contracting Authority according to article 108/A of the Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092, at the address specified in Section I of this Contract award notice.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë
për Kushtet Ndërtimore

"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin "Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".

Nr. prot: 6401/22 të datës 26.10.2022, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

Posta rekomande:

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë
Ndërtesa e Rilindjes
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:

<http://mmph-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Telefon: + 381 38 200 32 222



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë
për Kushtet Ndërtimore

"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin "Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".

Nr. prot: 6402/22 të datës 26.10.2022, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

Posta rekomande:

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë
Ndërtesa e Rilindjes
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:

<http://mmph-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Telefon: + 381 38 200 32 222

NËNËS


*Dielli, gjithë tokën e ka ndriçuar
dhe është duke ndriçuar
e ka për ta ndriçuar si nëna ynë
që krijon familje me shpirtbardhësi
për të mos u shuar kurrë në
begati.*

*Nëna ime, iu shkruaj dhe iu kam
shkruar e do të iu shkruaj si
babait edhe atë nuk plogështohem
kurrë që kjo është krenari
dyanësore për çdo moment të
secilës kohë.*

*Dashuria juaj, krijon dhe rriti
familje në shkëndija nga çdo anë
si yjet dhe rrezet e hënës që
natën e bëjnë ditë edhe ashtu si
ne që vazhdojmë jetën duke
lulëzuar nga dashuria juaj.*

Nga :Violeta GASHI





Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Gjeje PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjejepuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Armend Thaqi nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën për murator dhe punë të ngjashme të lëshuar nga I.A.P. për punësim Dituria nga Prizreni.

- Eduard Pnishi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Beqë Pnishi nga Demjani KK Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f. "Pjetër Bogdani" Demjan KK Gjakovë.

- Ardi Jaka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Albulena Zherka nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë nga kl. I deri 5 dhe nga 6 deri 9 e lëshuar nga SH.F.M.U. "Yll Morina".

- Flamur Osmani shpall te pavlefshme 1 dëftesë shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Valon Milaimi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Muhamet Kabashi shpall te pavlefshme 3 dëftesa shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Naim Shala shpall te pavlefshme dëftesën e kl X shfm " Xhevat Berisha " Prizren.

- Naim Shala shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shmu " Fadil Hisari " Prizren.

- Pranvera Shala shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfm " Fadil Hisari " Prizren.

- Jon Lacaj shpall te pavlefshme dëftesat enkl VI - IX shfm " Leke Dukagjini " Prizren.

- Besnik Sharani nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Stina Guta nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10, 11, TË SHM Teknike "Nexhmedin Nixha" rrobaqepëse.

- Sinaver Shehu nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shm Teknike "Nexhmedin Nixha".

- Leutrim Shllaku nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shme "Kadri Kusari".

- Meriton Strojckaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Blenhard Malota nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, XII dhe diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin NIXHA".

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA HALAL FOOD PASHTETË PULE

gluten
free



cilësi e garantuar

pa konservues